

## **Fjala e Drejtoreshës së Përgjithshme të Institutit të Statistikave**

Të nderuar kolegë, të ftuar, zonja dhe zotërinj,

Ndihem e privilegjuar që po kontribuojë në takimin e nivelit të lartë mbi progresin dhe Integrimin e Shqipërisë në Agjendën 2030, përshpejtimin dhe mbështetjen e politikave.

Jam veçanërisht mirënjohëse ndaj Zëvendëskryeministrit të Shqipërisë, kreut të misionit të Kombeve të Bashkuara si dhe të ftuarve të nivelit të lartë që shpenzuan kohën e tyre të çmuar për të qënë të pranishëm në këtë seminar. Prania e tyre në këtë event, tregon rëndësinë që ata i japin Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm.

Qëllimet e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, të cilat janë pranuar globalisht, kërkojnë gjetjen e rrugës për mbijetesën e planetit tonë.

Por SDG-të nuk kanë qëllime të ndara.

Qëllimi është që Agjenda 2030 të ketë një natyrë të integruar. Qeveria e Shqipërisë ka vendosur të integrojë 17 Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm me procesin e integritit në BE. Kjo është një sfidë për Qeverinë që të bashkojë të dyja proceset sëbashku dhe të dalë me qëllime të integruara. Nga ana tjetër, do të jetë një sfidë, që sistemet statistikore të kuptojnë se cilat të dhëna duhet të kombinohen dhe cilat pyetje do të kërkojnë për të arritur qëllimet globale.

Arritja e Agjendës 2030 do të kërkojë të dhëna të cilësisë së lartë, të cilat janë të arritshme, me kohë, të besueshme dhe të disagreguara sipas të ardhurave, gjinisë, moshës, racës, përkatësisë etnike, statusit të migracionit, aftësisë së kufizuar dhe vendndodhjes gjeografike.

Vlen të përmendet këtu se, Statistikat janë instrumenti i zgjedhur për të vendosur bazën për monitorimin e zbatimit të këtyre qëllimeve në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar. Politikat dhe strategjitë, që duhet të zhvillohen për arritjen e 17 objektivave dhe 169 targeteve duhet të mbështeten nga treguesit statistikorë për vendimmarrjen bazuar në evidencë. Nëse treguesit statistikorë, që do të përdoren për të monitoruar zbatimin e SDG-ve nuk janë caktuar saktë që në fillim, atëherë i gjithë procesi do të shkatërrohet dhe ne të gjithë do të jemi përgjegjës, në një mënyrë apo tjetër, duke vënë planetin tonë në rrezik.

Komuniteti statistikor i kushton shumë rëndësi SDG-ve. Në takimet ndërkombëtare, gjatë viteve të fundit, të organizuara nga Komisioni Statistikor i Kombeve të Bashkuara, UNECE dhe Eurostat, Indikatorët Statistikore të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm kanë patur një rëndësi të veçantë në agjendën e tyre. Në këtë kontekst,

Konferenca e Statistikanëve Evropiane ka miratuar një udhërrëfyes për statistikat e SDG - ve. Udhërrëfyesi përcakton aktivitetet që lidhen me prodhimin e statistikave për SDG-të; si :

- Çfarë duhet bërë;
- Kush duhet të bëjë çfarë dhe kur;
- Cilët janë palët e interesuara, dhe
- Mundësitë për bashkëpunim.

Udhërrëfyesi përfshin gjashtë rekomandime që INSTAT në bashkëpunim me Qeverinë Shqiptare ka filluar të zhvillojë:

- Duke u ndalur në krijimin e mekanizmave për bashkëpunim kombëtar

Një grup pune teknik për SDG është themeluar nga ZKM, që aktualisht është duke punuar si një mekanizëm për bashkëpunim dhe statistikat kanë qenë gjithmonë shumë të larta në agjendën e secilit takim. INSTAT është njohur si një pikë fokale për matjen e SDG dhe gjithashtu treguesit që do të prodhohen për integrimin në BE, dhe ne planifikojmë të përdorim këtë grup teknik për të krijuar një mekanizëm raportimi.

- Vlerësimi i gatishmërisë së vendeve për të raportuar mbi treguesit global të SDG

Puna ka filluar me raportin bazë përgatitur me mbështetjen e UNDP-së. Ky është një mjet shumë i dobishëm për vlerësimin e disponueshmërisë së të dhënave, identifikimin e ofruesve të të dhënave dhe identifikimin e boshllëqeve të të dhënave. Një vendim duhet të merret për përgjegjësitë e institucioneve kombëtare për prodhimin dhe raportimin e secilit tregues dhe Zyra e Statistikave duhet të udhëheqë këtë proces.

- Zhvillimi i treguesve rajonal, kombëtar dhe nën-kombëtar

Meqenëse qëllimet e SDG-ve do të përafrohen me agjendën e integritit në BE dhe strategjitë kombëtare tashmë ekzistojnë, ka nevojë për një koordinim dhe dialog të fortë për të nacionalizuar treguesit e SDG dhe në këtë perspektivë duhet të bëhet një vendimmarrje për nivelin e ndarjes e treguesve të nacionalizuar.

- Ndërtimi i kapaciteteve është një çështje tjetër e rëndësishme që rekomandohet dhe adresohet nga udhërrëfyesi i UNECE

INSTAT është mbështetur përgjatë viteve, në zhvillimin e prodhimit statistikor nga agjencitë e UN, Delegacioni i BE-së, Sida, SDC dhe organizata të tjera ndërkombëtare. Por kapaciteti aktual nuk është i mjaftueshëm për të prodhuar të gjithë treguesit statistikor në të gjitha nivelet e ndarjes. Sa i përket ngritjes së kapaciteteve, shumë

përpyekje duhet t'i përkushtohen edhe institucioneve të tjera që do të jenë përgjegjëse për prodhimin e indikatorëve jo statistikorë në përputhje me metodologjitë e kërkuara.

Një sfidë tjetër, me të cilën ballafaqohet sistemi statistikor është krijimi i mekanizmave të vazhdueshëm, në të cilat dija dhe memoria institucionale mbetet dhe është një çështje e ndërtimit të institucioneve dhe ngritja e një infrastrukture të qëndrueshme.

- E fundit por jo më pak e rëndësishme është raportimi dhe treguesit e komunikimit për SDG

Ka disa mekanizma të sugjeruara për raportimin dhe rrjedhjen e të dhënave për treguesit e SDG, që duhet të koordinohen nga Institucionet Statistike kombëtare, por sugjerimi më i rëndësishëm është zhvillimi i një platforme kombëtare të raportimit si një mekanizëm për shpërndarjen e treguesve të SDG, një vendim që duhet të merret nga Grupi i punës së nivelit të lartë.

Dua të theksoj se, SDG-të janë shumë të larta në agjendën e INSTAT dhe këtu dua t'ju siguroj angazhimin e plotë të institucionit për të mbështetur Qeverinë në këtë proces shumë të rëndësishëm.

Përpyekja e parë për të prodhuar një raport statistikor për SDG-të ka filluar me përgatitjen e aneksit statistikor për VNR në HLPF. Kjo do t'i shërbejë INSTAT si një eksperiencë e mirë për të vazhduar punën për prodhimin e një raporti të përshtatshëm për treguesit e SDG -ve.

Hapat e ardhshëm, që ne besojmë se duhet të bëhen në të ardhmen e afërt janë:

- Vlerësimin e kapaciteteve të nevojshme për të prodhuar treguesit në nivel qeveritar kombëtar;
- Zhvillimi i një udhërrëfyese për prodhimin e treguesve statistikorë;
- Marrjen e vendimeve mbi përgjegjësitë e prodhimit dhe raportimit në drejtim të treguesve;
- Zhvillimi i një platforme kombëtare;
- Vendosjen e targeteve për prodhimin e Indikatorëve të SDG-ve;

Ne përballemi me shumë sfida sa i përket kapaciteteve të nevojshme për të ndërmarrë këtë operacion të madh.

Shpresa ime është që ne mund të përmirësojmë bashkëpunimin dhe se kjo është një mundësi për të gjetur një bazë të përbashkët për çështjet e zhvillimit.

Rezultati do të varet nga veprimet që ndërmerren, prandaj është e rëndësishme që të fokusohemi duke konsideruar eksperiencat më të mira. Proçesi i arritjes së Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm në Shqipëri dhe në botë matet duke përdorur statistika. Pa të dhëna të besueshme, është e pamundur të dimë nëse i përmbushim qëllimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm 2030.